



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr 757 prot

Vlorë më 12/04 /2019

Vendim

Nr 1 datë 05.04 2019

PËR

SHTESË NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT TË VITIT 2019,
MIRATUAR ME VKQ NR 47 DT.20.12.2018

Këshilli i Qarkut Vlorë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur, nga grupi i punës për përgatitjen e shtesës së buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë të vitit 2019, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore " neni 8 pika 2 neni 9 pika 1.1, b neni 31 pika 1.2.3 neni 34, neni 38, neni 40, neni 41 ,neni 72 pika 5, neni 77 pika dh, neni 83, pika ç.
- Ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 40 .
- Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- Ligjin nr. 99/2018 dt. 03/12/2018 " për buxhetin e vitit 2019", neni 16.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".
- " Udhëzimi plotësues i Ministrisë së Financave nr.1. datë 17.01.2019 " Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019".

VENDOSI:

I. Të miratojë shtesë te Gërma A pika 1 (të ardhurat e veta) në 1.768.765 (lekë):

- a) Pika 1 (të ardhurat e veta), shkronja, c (Grant i pakushtëzuar) viti 2019(– 131)lekë.
- b) Pika 1(Të ardhurat e veta), shkronja d (grant i trashëguar) + 1.499.351 lekë.
- c) Pika 1 shkronja e (Të ardhura të trashëguara) + 50.865 lekë
- f) Pika 1 të shtohet shkronja f (Të ardhura të trashëguara jashtë limitit) + 218.680 lekë , si më poshtë:

II. Të miratojë shtesë te Gërma A pika II (Grant i Kushtëzuar) në 8.874.564 (lekë):
si më poshtë:

	Ishte	Bëhet
A. TE ARDHURA GJITHESEJT	100.987.000	111.540.329
I. Të ardhurat e veta	94.000.000	95.768.765
a) Të ardhura kuotë antarësie	11.100.000	11.100.000